



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2035/5 Prot.

Patos, më 09 PA / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 06 SHTATOR 2024

Vendi: "Fshati Gjinoqarë njësia administrative Ruzhdie "

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 12:00

Dëgjese publike me temë: "Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027".

Baza Ligjore: Në zbatim të nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 71 datë 30.11.2023 "Mbi strukturën e nivelit të taksave dhe tarifavë vendore për vitin 2024" dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Deputete e Qarkut Fier znj. Antoneta Dhima, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Ermenita Mici, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, përfaqësues të subjekteve private dhe fermerë të cilët operojnë në teritorin e njësisë administrative Ruzhdie dhe rreth 20 pjesëmarrës (banorë dhe Kryetarë të fshatrave të njësisë Ruzhdie).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”. Siç e kemi thënë edhe më parë ne kemi një rregull për dëgjesat, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur, fjala është për ekzekutivin për paraqitjen e materialit për paketën fiskale 2025.



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm
2025-2027*

Shtator 2024

Specialist i drejtorisë së të Ardhurave Vendore z. Astrit Murati – faleminderit kryetar, më lejoni t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ lidhur mbi prezantimin e projekt dokumentin të “Paketës Fiskale 2025” dhe sot jemi në fazën e parë të konsultimeve ku do të mbledhim propozimet tuaja për atë se çfarë mund të ndryshohet në këtë paketë lidhur mbi taksat tarifat dhe shërbimet, propozime të cilat do të reflektohen në dokumentin përfundimtar të paketës fiskale. Grupi i menaxhimit strategjik ka menduar që për vitin 2025 të paraqesim të njëjtën paketë fiskale, e cila është në fuqi e miratuar me VKB nr. 80 me disa ndryshime të vogla, të cilat janë të përcaktuar nga qeveria.

Përsa i përket komunitetit do të mbetet i njëjti nivel taksash dhe detyrimesh dhe përjashtimesh të miratuara në paketën aktuale ndërsa biznesi është subjekt i ligjit nr. 9920 dhe do të jenë të njëjtat nivele taksash, tarifash dhe shërbime dhe afati i shlyerjes do të jetë deri në 30 qershor të vitit kalendarik. Prezanton draft dokumentin e paktës fiskale për vitin 2025 si dhe lehtësirat e

parashikuara në ligj për kategori të caktuara. Në ligjin e urbanistikës së fundmi janë bërë disa ndryshime lidhur mbi ndërtimet dhe riparimet në objekteve shtëpi banimi. Ne jemi duke parë me grupin e menaxhimit vendosje e tarifave të reja për kryerjen e shërbimeve në shtëptë e banimit, por edhe tarifa të tjera të cilat lidhen me marrjen e aseteve të bashkisë me qira siç janë makinat të cilat mund të kërkohen nga subjekte private apo komunitet pasi të gjitha ndryshimet që vijnë si rezultat i ndryshimeve ligjore të cilat kanë efekt financiar pasqyrohen në paketë fiskale.



**Specialist i drejtorisë së të Ardhurave
Vendore z. Astrit Murati**

Dëgjesë publike me temë:

***Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm
2025-2027"***

Shtator 2024

Gjithsesi ne jemi në fazën e prezantimit të paketës fiskale dhe në bazë të propozimeve tuaja për ndryshime do të pasqyrohen në draft dokumentin e paketës fiskale e cila do të prezantohet përsëri tek komuniteti për të kaluar më pas në miratim nga këshilli bashkiak. Faleminderit!

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:- faleminderit Astrit për prezantimin e draft dokumentit fjala është për ju për pyetje, sygjjerime, komente lidhur mbi draft dokumentin e paketës fiskale. Por si fillim doja të dija sa është niveli i pagesës së taksave dhe tarifave vendore për njësinë Ruzhdie?



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

***Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"***

Shtator 2024

Specialist i Drejtorisë së të Ardhurave z. Astrit Murati - lidhur mbi vjeljen e taksave dhe tarifave vendore njësia Ruzhdie është në nivele të ulta.

Specialist i Njësisë Ruzhdie z. Dylber Laçi – bashkia duhet të marri masa shtënguese dhe të përdoret forca e ligjit për vjeljen e taksave pasi një punonjës i vetëm nuk mund të ushtroj dot presion për pagimin vullnetar ndaj duhet të gjenden mekanizma nga bashkia për vjeljen e taksës pasi kur kërkohet pagesa e taksës na thuhet se nuk marrim shërbime prej bashkisë.



**Specialist i Njësisë Ruzhdie
z. Dylber Laçi**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

Specialist i Drejtorisë së të Ardhurave z. Astrit Murati - fshati Gjinoqarë është i përjashtuar nga tarifa e shërbimeve.

Specialist i Njësisë Ruzhdie z. Dylber Laçi – edhe nga subjektet private ne kemi problem për vjeljen e taksave.

Kryetari i bashkisë z. Fation Duro – pavarësisht që niveli i taksave të njësisë është i ulët ne kemi planifikuar që të kemi nderhyrje me investime në të gjithë fshatrat e njësisë. Investime të cilat do të përfshijnë shtrimin e rrugëve si në brendësi të lagjeve ashtu edhe rrugët e parcelave bujqësore. Ne deri tani kemi insistuar për hapjen e 10 km rruge parcelash toke bujqësore. Ndërhyrje do të



**Kryetari i bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

ketë edhe në sistemin e ndriçimit rrugor ndërsa ujësjellësi brenda muajit qershor kam bindjen se do të përfundoj duke parë edhe ecurinë e punimeve.

Banor i njësisë Ruzhdie z. Qani Lamaj - kërkoj nga bashkia të ndërhyet për hapjen e rrugëve në parcelat bujqësore. Konkretisht rruga nga shkolla tek laçianët. Kërkojmë ndricimin rrugorë pasi është ndërprere energjia elektrike për ndriçimin e rrugës.

	<p>Banor i njësisë Ruzhdie z. Qani Lamaj</p> <p>Dëgjesë publike me temë: <i>Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027"</i></p> <p>Shtator 2024</p>
-----------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Kryetari i fshatit Siqecë z. Myftar Soraj – taksat vendore duhet të paguhen dhe duhet të gjenden metoda për vjeljen e tyre nga ana e punonjësve. Astriti theksoj se fshati Siqecë është përjashtuar nga taksa e pastrimit për vet faktin se këtij fshati nuk i ofrohet si shërbim, por unë doja të pyesja ku do ti hedhin mbeturinat këta banorë pasi janë mbushur kanalet me mbeturina ndaj mendoj që të vendoset taksa e pastrimit dhe le ta paguajmë si shërbim që të kemi mundësi që ta marrim si shërbim. Lidhur mbi zjarret ne kemi patur bashkëpunim të frytshëm me administratorin e njësisë.

	<p>Kryetari i fshatit Siqecë z. Myftar Soraj</p> <p>Dëgjesë publike me temë: <i>Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027"</i></p> <p>Shtator 2024</p>
-------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Kryetari i bashkisë z. Fation Duro- lidhur mbi kërkesën për ndriçimin nga fundi i muajt do të fillojmë me punimet edhe pse nuk e kemi si tarifë, si shërbim do të ofrohet.

Administratori i njësisë Ruxhdie z. Agim Mesutaj – në radhë të parë më lejoni t'ju falenderoj në emër të të gjithë banorëve të njësisë për punët që janë nisur dhe për të gjitha problematikat që bashkia ju ka dhënë zgjidhje siç është problemi i ujit, hapjes së rrugëve të parcelave dhe zgjidhjeve të pjesës më të madhe të konflikteve. Ajo që unë do të kërkoja është përdorimi i rërës bituminoze në shtrimin e rrugëve të lagjeve si dhe hapja e rrugëve të parcelave dhe shtrimi i tyre më zhavorr mali, por edhe karikimi i tyre atje ku ka nevojë. Në fshatin Drenie me rrugën që po bëhet do të mbyllet edhe karikimi i saj dhe si fshat nuk ka probleme të tjera tani për tani. Në fshatin Siqecë rruga te Xeballarët është pak problem pasi nuk hyn mjeti. Në fshatin Gjinoqarë, problem ka rruga në lagjen Mashkullorë – Vosokë e cila kërkon patjetër ndërhyrje nga bashkia.



**Administratori i njësisë Ruxhdie
z. Agim Mesutaj**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

Kryetari i fshatit Ruzhdije z. Sako Myftaraj- Agimi bëri një përmbledhje për të gjitha fshatrat por në fshatin Ruzhdie është një rrugë në mesin e lagjes e cila kërkon ndërhyrje çfarë do të bëhet me atë rrugë pasi banorët kanë vështirësi në kalimin e tyre.



**Kryetari i fshatit Ruzhdije
z. Sako Myftaraj**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
Buxhetit Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – atë rrugë që thoni unë e kam parë por do të shohim në fund në qoftë se do të mbetet nga pjesa e rrugës së siqecës deri në Drenie do të kalojmë edhe te rruga dytesore e lagjes dhe në këto momente ne nuk ndërhyjmë dot pa mbaruar investimi.

Kryetari i fshatit Ruzhdije z. Sako Myftaraj - unë nuk po them të ndërprisni punimet atje për të ndërhyrë në fashatin tim, por edhe ajo është rrugë që të lidhet direkt me rrugën kryesore dhe nuk është më shumë se 200 m/l.

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro –në Ruzhdie është planifikuar shtrimi i rrugës në lagjen Myftaraj përballë njësisë, e cila do të jetë me asfalt ndërsa rrugët e tjera do të jenë me rërë bituminoze dhe besoj se jemi duke folur për të njëjtën rrugë.



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

Kryetari i fshatit Ruzhdije z. Sako Myftaraj- ju mirë bëni që e keni piketuar këtë rrugë për ta shtruar me asfalt, por unë jam duke folur për një rrugë tjetër që shkon te shkëmbi dhe del në rrugën kryesore dhe ju nuk keni kaluar ndonjëherë nga shkëmbi, një rrugë zhavorr kërkon ajo rrugë jo më shumë.

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – patjetër që e kam parë me inxhinierët rrugën e shkëmbit, e cila deri dje ishte pa ndriçim fare dhe sot është vendosur ndriçimi, mbase nuk do të ketë ndonjë ndriçim të fortë, por jetë e ndriçuar dhe do të ketë shikueshmëri gjatë orëve të natës.

Banor i Njësisë Ruzhdije - kryetar kemi nevojë për shtrimin e rrugëve të parcelave pasi nuk



Banor i Njësisë Ruzhdije

Dëgjesë publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

ndriçimin e fshatit dhe ato një ditë punuan dhe sot i kanë prerë fare si ndriçim jo se janë djegur, por i kanë prerë te gabina.

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – pasi të mbarojmë takimin do ta shikojmë së bashku dhe patjetër që do ta zgjidhim sa më shpejt, por si fillim duhet ta shikoj në vend.

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - ndonjë pyetje apo koment tjetër për paketën fiskale 2025? Mqse jo edhe një herë ju falenderoj prezencën dhe rëndësinë që gjithmonë i'u kushtoni këtyre takimeve të cilat orientojnë drejt punën e bashkisë në përpilimin e draft dokumentit të paketës fiskale, por edhe këshillin për marrjen e vendimeve të drejta për komunitetit. Edhe një herë faleminderit!

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj



Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba



Foto të takimit me temë: “Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”



